



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. A - 262/2025

Datë: 08.05.2025

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST INFORMATION AND PRIVACY AGENCY	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE	
Ngjësia Org. Org. Jed. Org. Unit	Nr. i Prot. Br. Prot. Prot. No.
Nr. i Faqeve Broj Stranica No. of Pages	Data: Datum: Date:
03	531
03	08 05 2025

Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 20 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, përkitazi me ankesën nr.262 të parashtruar më datën 13.03.2025 të znj. Tirana Bytyqi nga 'Çohu', ndaj NPK 'Termokos', për kufizimin e qasjes në dokumente publike, të paraqitur më 14.02.2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e znj. Tirana Bytyqi nga 'Çohu' ndaj NPK 'Termokos'.
2. **Obligohet** NPK 'Termokos' që në afat prej 7 ditëve nga data e pranimi të këtij vendimi, t'i ofrojë qasje të plotë ndaj dokumenteve, si në vijim:
 - 2.1. Pasqyrat financiare vjetore të ndërmarrjes për vitet: 2021 deri 2024;
 - 2.2. Listën e rekrutimeve të stafit për vitet 2020 deri 2024 (lista duhet të përfshijë emrin, mbiemrin, pozitën dhe datën e emërimit/përzgjedhjes);
 - 2.3. Listën e bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitet 2020 deri 2024 (nëse ka);
 - 2.4. Procesverbalet e transkriptuara të mbledhjeve të bordit të drejtorëve për vitet 2020 deri 2024;
3. **Obligohet** NPK 'Termokos' që ta njoftojë me shkrim Agjencinë, pas marrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
4. Vendimi hyn në fuqi më datën e pranimi të të njëjtit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 20, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka pranuar një ankesë nga pala znj. Tirana Bytyqi nga 'Çohu', me nr. të protokollit 262, të datës 13.03.2025, të ushtruar ndaj NPK 'Termokos', për kufizimin e qasjes në dokumente publike, të përmendur në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi.

Në kërkesën fillestare dërguar institucionit publik, pala ankuese kishte kërkuar dokumentet, si në vijim:

- Pasqyrat financiare vjetore të ndërmarrjes për vitet: 2020 deri 2024;
- Listën e rekrutimeve të stafit për vitet 2020 deri 2024 (lista duhet të përfshijë emrin, mbiemrin, pozitën dhe datën e emërimit/përzgjedhjes);
- Listën e bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitet 2020 deri 2024 (nëse ka);
- Procesverbalet e transkriptuara të mbledhjeve të bordit të drejtorëve për vitet 2020 deri 2024;
- Memorandumin që 'Termokos' e ka bërë me disa OJQ lidhur me monitorimin e mbledhjeve të bordit të drejtorëve nga organizatat joqeveritare.

Në fazën fillestare të shqyrtimit të ankesës së palës, autoriteti mbikëqyrës, më 10 prill 2025, i ka dërguar institucionit publik një shkresë njoftuese, përmes të cilës, mes tjerash, i ka kërkuar arsyet e mosofrimit të qasjes ndaj dokumenteve të kërkuara.

Në reflektim të kësaj shkrese të AIP-së, institucioni publik, midis 15 prillit 2025 dhe 02 majit 2025, i ka përcjellë palës ankuese vetëm dokumentin e pestë [Memorandumin e 'Termokos' me disa OJQ] dhe pasqyrat financiare të ndërmarrjes për vitin 2020.

Institucioni publik ka dështuar që gjatë kësaj periudhe të shqyrtimit të kësaj ankese ti ofrojë palës ankuese pasqyrat financiare për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024. Për më tepër, institucioni publik nuk ka ofruar qasje as në kategorinë e dokumenteve nga pika 2, 3 dhe 4 e kësaj shkrese.

Ofrimi i qasjes ndaj kategorisë së parë të dokumenteve, të cilat lidhen me shpenzimin e parasë publike, respektivisht me gjenerimin e të hyrave nga inkasomi dhe jo vetëm, garantohej me nënparagrafin 3.1 të nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Kategoria e dytë dhe e tretë e dokumenteve të kërkuara lidhet me marrëdhënien e punësimit dhe ushtrimin e funksioneve publike, qasjen ndaj të cilave e garanton nënparagrafi 3.2 i nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. E njëjta bazë ligjore garanton qasjen edhe ndaj kategorisë së katërtë të dokumenteve të kërkuara për periudhën përkatëse, nëse të njëjtat ekzistojnë.

Institucioni publik, përmes ngurrimit për të ofruar qasjen e kërkuar nga pala ankuese, edhe pse ka ofruar gatishmëri për të dëshmuar transparencë, nuk ka dëshmuar se ka zhvilluar testin e dëmit dhe interesit publik, mbi bazën e të cilit do të mund të argumentonte se si (nëse) mbizotëron interesi i mbrojtur ndaj interesit publik.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nënparagrafin 4 të nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka nxjerrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për kundërshtim në gjykatën kompetente për çështje administrative brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Jeton Arifi
Drejtore
Departamenti për Qasje
në Dokumente Publike

Vendimi i dërgohet:

- Z. Fisnik Osmani, Zyrtare Përgjegjëse, NPK 'Termokos'
- Znj. Tirana Bytyqi, Ankuese, Çohu
- Arkivit të Agjencisë